Analiza jonë, e realizuar mbi bazën e intervistave të gjysmë-strukturuara, vizitave në shkolla dhe anketimeve të intervistave anonime, ofron prova për dhunën e pranishme në shkollë të gjerë në shkolla. Sidoqoftë kjo është injoruar nga autoritetet relevante, në media është raportuar pak dhe ata individë që tentojnë të tërheqin vëmendjen për këto çështje, nuk kanë fuqi për të bërë ndryshime të duhura në pikëpamje të zvogëlimit të dhunës ndaj fëmijëve.

Sa më shumë që kemi hetuar aq më shumë kanë dalë në pah ndërlikimet e çështjes. Kjo tregon se nuk ekziston një përgjigje e vetme magjike që mund të lehtësojë këtë problem, por se një morri i gjerë e politikave duhet të zbatohen nga një numër i konsiderueshëm i organizatave. Megjithatë, ajo çka është e qartë është se hapi i parë që duhet të ndërmerret nga të gjithë hisedarët, duke përfshirë prindërit, është në të vërtetë pranimi se dhuna në shkollë paraqet një problem. Vetëm atëherë ne mund të vazhdojmë të sigurohemi se mjedisi arsimor në Kosovë është i sigurt dhe i favorshëm për mësim.

Ndërkaq aktualisht nuk duket që çështjet e fëmijëve kanë gjasa që të paraqiten në agjendën politike në një të ardhme të afërt. Ndonëse agjencitë ndërkombëtare si UNICEF-i janë të pranishme në Kosovë, në nivelin vendor, nuk ka grupe të presionit që bëjnë fushatë për të drejtat e fëmijëve. Çështjet e tyre nuk paraqiten në fjalimet e fushatave parazgjedhore të partive politike, të cilat në mungesë të programeve të shtypura partiake, përbëjnë mënyrën e vetme të paraqitjes së agjendave të tyre politike. Në prag të zgjedhjeve lokale të 2013-ës, subjekti i vetëm që ka publikuar një program ka qenë Lëvizja “Vetëvendosje!” dhe ndonëse ata theksojnë se qëndrojnë në të majtën ekstreme, Alternativa e tyre Qeverisëse ka përmendur vetëm tri herë fëmijët. Një herë në lidhje me ofrimin e arsimit parashkollor, pastaj me kërkesën për të siguruar se fëmijët me nevoja të veçanta kanë qasje të garantuar fizike në objektet shkollore dhe e treta që merrej me klubet sportive.

Fakti se nuk ka debat politik rreth mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve në Kosovë, se nuk ka pasur përpjekje për të krijuar një ko-

rnizë të kuptueshme ligjore për t'u marrë me këto çështje dhe se ky raport është publikuar në këtë mënyrë në një vakum politik, nuk do të thotë se mjedisi shkollor është i sigurt për fëmijët tanë. Ekziston një nevojë e ngutshme për t'u marrë me përhapjen e dhunës në shkolla dhe për ta bërë çështje parësore të qeverisë, sigurinë në institucionet arsimore.

Florina Duli

Drejtoreshë Ekzekutive

Iniciativa Kosovare për Stabilitet

SHKURTESAT

KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
QPS	Qendrat për Punë Sociale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Më shumë se 344 mijë njerëz e kanë shikuar një video të postuar në YouTube në vitin 2011, në të cilën një mësimmdhënës në një shkollë fillore të Prishtinës është filmuar duke i goditur nxënësit në klasë. Dashamirësia e lehtë me të cilën dhuna pranohej nga viktimat dhe reagimi më shumë me qeshje sesa me frikë i shokëve të tyre të klasës tregonte se kjo mënyrë e sjelljes në shkollat e Kosovës është më shumë normë sesa përjashtim. Më keq, përdorimi i videoja shpërndohej, arsyeja për këtë ishte se shumica e shikuesve si një film argëtues që duhej ndarë me shokët dhe jo si diçka që shkaktoje zemërim apo mos pajtim. Po kështu ajo nuk ngjalli asnjë debat në media apo reagim nga ndonjë zyrtar qeveritar apo nga institucionet arsimore.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) e ka ndërmarrë këtë hulumtim në mënyrë që të vlerësojë se sa janë aktualisht të sigurt fëmijët në hapësirat shkollore, të identifikoj fushat ku ka mangësi të ligjeve dhe udhëzimeve dhe të rekomandojë opsione të politikave të zbatueshme.

Intervistat tona me fëmijët, prindërit dhe mësimmdhënësit zbulojnë se ata kanë vështirësi të përcaktojnë saktësisht se çfarë përbën dhunë. Një prind, kur është pyetur që ta bëjë këtë, ka thënë se “një shuplakë, shkelmi apo fjalët qortuese nuk paraqesin dhunë”. Të gjitha palët e përfshira ndjejnë se dhuna e ushtruar në shkollë nga mësimmdhënësit ishte një formë legjitime e ndëshkimit trupor. Shumica e prindërve e miratojnë këtë. Asnjëra nga palët nuk ka konsideruar se armiqësitë jo-fizike e psikologjike llogariten si dhunë. Mësimmdhënësit zakonisht përdorin gjuhë nënçmuese kur i drejtohen fëmijëve dhe i ofendojnë ata. Ndonëse mësimmdhënësit mund të kenë nevojë që të ngrenë zërin për të mbajtur rend, duket se mësimmdhënësit u bërtasin fëmijëve në mënyrë që t'i frikësojnë dhe turpërojnë ata para shokëve të tyre.

Disa nga të gjeturat sasiore janë alarmante: Nga 358 nxënës të anketuar, deri në 184 sosh kanë theksuar se kanë qenë viktimat të ndonjë forme të dhunës. Kur të gjeturat e IKS-së krahasohen me ato të raportit të UNICEF-it të vitit 2005 mbi Hulumtimin e Dhunës ndaj Fëmijëve në Shkollat e Kosovës, është e qartë, se rastet e dhunës janë rritur përgjatë tetë viteve të kaluara.

Të gjeturat tona tregojnë se zënkat shokë me shokë (nxënës-nxënës) ndodhin në baza ditore dhe se këto përleshje shpesh rezultojnë me lëndime serioze. Deri në 90 për qind të fëmijëve të intervistuar deklarojnë se kanë parë armë, në të shumtën e rasteve thika, në hapësirat shkollore dhe 30 për qind prej tyre thonë se nuk ndihen të sigurt në shkollë. Për më shumë dhuna shokë me shokë në formë të ngacmimit, kërcënimit apo vandalizmit është gjerësisht i përhapur. Nuk ka udhëzime që do t'i ndihmonin shkollat në ballafaqimin me këto probleme dhe nuk ka mekanizma institucionalë brenda shkollave për ti

ndihmuar mësimdhënësit dhe viktimat e dhunës së shokëve.

Përkundër faktit se ndëshkimi fizik është joligjor në Kosovë, ai ende përdoret në shkallë të gjerë, pasi që reformat arsimore të pasluftës, sikurse edhe reformat tjera sociale, nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Ky legjislacion nuk është hartuar si reagim ndaj presionit publik dhe në disa sektorë ka një mungesë të plotë të vetëdijes se ndëshkimi fizik është me të vërtetë i paligjshëm. Ofrimi i udhëzimeve mbi praktikat, politikat dhe ligjet e mira, thjeshtë, nuk janë të mjaftueshme për të siguruar ndryshimet. Politikat duhet të zbatohen në mënyrë të duhur, duhet të ketë ndërgjegjësim të gjerë të ekzistimit të tyre dhe një konsensus politik brenda shoqërisë si tërësi që e mbështet ligjin.

REKOMANDIMET

MASHT-i, OJQ-të dhe akterët tjerë të përfshirë në luftimin e dhunës, duhet të avokojnë dhe të zbatojnë nisma që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të prindërit dhe mësimdhënësit lidhur me efektet negative të dhunës ndaj fëmijëve.

Ligjbërësit duhet të pranojnë se në shkollat e Kosovës ka dhunë në shkallë të gjerë; se ajo duhet të analizohet në imtësi, në mënyrë që të zhvillohet një plan i qartë dhe i organizuar veprimi mbi zbatimin e Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar. Duhet të krijohen mekanizmat për raportimin mbi zbatimin e Protokollit dhe Kodit Etik të MASHT-it për vlerësimin e nxënësve.

Personeli shkollor duhet të përfshijë këshilltarët dhe psikologët e trajnuar për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me sjelljet e dhunshme. Përparsi duhet t'i jepet shkollave të mbi-populluara.

Sektori i edukimit duhet të pajiset me burime të nevojshme për të përmirësuar standardet në shkolla dhe fondet duhet të jenë në dispozicion në mënyrë që çështja e dhunës të mund të trajtohet.

Mos të humbet kohë me hartimin e politikave të reja para zbatimit të legjislacionit ekzistues.

Procedura që aplikohet për emërimin e drejtorëve të shkollave duhet të rishqyrtohet.

MASHT-i

— Duhet të marrë rolin udhëheqës në krijimin e një organi ndërmintor për të mbikëqyrë ndarjen e përgjegjësisë në mes të gjithë lojtarëve në sektor, ose për të ngritur komitete që përfaqësojnë një gamë të gjerë të organeve dhe aktorëve të përfshirë, për të shqyrtuar çështjet që shfaqen.

— Përmbajtja e Kodit Etik dhe Protokollit duhet të publikohen në shkallë të gjerë.

— Përgjegjësia për monitorimin e Kodit Etik duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë.

— Duhet të krijohet një sistem efektiv i menaxhimit të performansës si për drejtorët e shkollave ashtu edhe për personelin tjetër mësimdhënës.

— Duhet të vendoset një proces i konsultimit, në mes të prindërve dhe mësimdhënësve, që të dakordohen modelet e njëtrajtshme alternative të disiplinës.

— Duhet realizuar një hulumtim për të shqyrtuar programin mësimor, materialet e mësimdhënies dhe tekstet shkollore që përdoren. Përmbajtja e tyre duhet të promovojë vlerat pozitive, tolerancën dhe barazinë gjinore. Barazia gjinore duhet të mësohet në klasat e edukatës qytetare. Mësimdhënësit dhe personeli tjetër duhet të trajnohen për ta ligjëruar atë dhe për t'i mësuar nxënësit se të gjitha format e diskriminimit janë të papranueshme.

— Organizatat dhe aktorët e ndryshëm duhet të punojnë bashkë për të promovuar ndryshimin në qëndrimet dhe normat që nuk e vëjnë re ose kryejnë dhunë ndaj fëmijëve në shkolla, në shtëpi dhe në bashkësi në përgjithësi.

— Të dhënat e grumbulluara mbi dhunën në shkolla duhet të konsolidohen dhe forcohen me hulumtime. Fushat që duhet të hulumtohen edhe më tej përfshijnë dhunën bazuar në moshë dhe gjini. Informatat e mbledhura duhet të jenë pjesë e procesit të politikbërjes, si në nivelin nacional ashtu edhe atë lokal, për të parandaluar dhe eliminuar dhunën në shkolla.

— Duhet të zhvillohen bashkëpunimi, ndarja e të dhënave në tërë rajonin rreth praktikave më të mira, programet dhe hulumtimet e bazuara në fakte për ti dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve.

MTI

— Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të jetë veçanërisht vigjilente kur lëshon leje për biznese që aplikojnë për të vepruar në afërsi të hapësirave shkollore. Duhet gjithashtu që vazhdimisht të monitoroj edhe ato ekzistueset për të siguruar se fëmijëve nuk u shitet drogë apo cigare nga ana e tyre dhe që nuk lejohen të vënë baste. Kundërvajtësit duhet të mbyllën ose të gjobiten.

KRYETARËT E KOMUNAVE

— Të mbajnë një herë në muaj ditën e hapur për prindërit dhe fëmijët që të diskutohet performansa shkollore. Inspektorët e arsimit duhet të jenë prezentë gjatë takimit dhe raportet e tyre mbi shqetësimet e ngritura duhet të jenë në dispozicion për mediat.

DKA-të

— Shkollat duhet të zhvillojnë politika dhe masa për zhdukjen e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve.

— Personeli shkollor duhet të jetë i trajnuar për të njohur viktimat e mundshme dhe kryesit e dhunës. Ata duhet të dinë kujt t'i drejtohen për mbështetje dhe kujt t'ia raportojnë rastet. Duhet të ketë një protokoll të qartë kontakti për policinë dhe autoritetet e tjera në rastin e incidenteve të rënda të dhunës në shkolla.

— Të gjithë punonjësit e shkollës duhet të trajnohen për qasjen jo të dhunshme për disiplinën në arsim.

— MASHT-i dhe DKA-të duhet të ofrojnë stimulim për mësimdhënësit që të marrin pjesë në trajnimet për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve. Sistemi i kredive që zbatohet në Shqipëri mund të shërbej si një model.

— DKA-të, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit duhet të inkurajohen që të përdorin teknologjitë informative dhe të komunikimit për komunikim më efektiv me prindërit dhe hisedarët tjerë.

DREJTORITË E SHKOLLAVE DHE NISMAT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

— Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës përcakton se çka janë të drejtat e fëmijës por gjithashtu thekson përgjegjësitë e fëmijëve, për shembull për respektimin e njëri-tjetrit. Çfarëdo aktiviteti për promovimin e Konventës duhet të përqendrohet si në të drejtat ashtu edhe në përgjegjësitë, në mënyrë të ekuilibruar.

POLICIA E KOSOVËS DHE AUTORITETET KOMPETENTE PËR MBIKËQYRJEN E PËRFSHIRJES SË TYRE NË SHKOLLA

— Duhet të lehtësohet bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet QPS-ve dhe Departamentit të Policisë në Komunitet nëpërmjet organeve të përbashkëta të përhershme.

— Para hartimit të politikave të reja duhet një zbatim më efektiv i legjisllacionit ekzistues. Problemet e identifikuar në sistem nga ky hulumtim dëshmojnë zbatimin e dobët të politikave dhe ata që nuk i përmbahen Protokollit të përcaktuar me këto politika nuk përballen me pasojë disiplinore.

HYRJE

Hulumtimi i realizuar nga IKS mbi ekzistencën e dhunës në shkolla tregon se edhe frikësimet janë gjerësisht të përhapura si në oborrin e shkollës ashtu edhe në klasë. Krahësimet me hulumtimin e kaluar tregojnë se dhuna në shkolla është rritur dhe se ka gjithnjë e më pak respekt për autoritetet e shkollës dhe për rregullat e shkollës.

Dhuna vazhdon që të jetë problem në shkolla, sepse ligji që është

miratuar për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve nuk është duke u zbatuar në mënyrë të duhur dhe çështja si tërësi nuk konsiderohet si prioritet që kërkon vëmendje të menjëhershme. Si rezultat, përkundër faktit që ndëshkimi trupor është jashtëligjor, mësimdhënësit e shkelin ligjin në baza ditore duke përdorur forma të ndryshme të dhunës në klasa. Autoritetet e shkollës, kryesisht drejtorët e saj, DKA-të, inspektorët e shkollave sikurse edhe përfaqësuesit e MASHT-it, përbalen me mungesë të burimeve dhe vullnetit për ta ndaluar këtë.

Në të njëjtën kohë autoritetet e shkollës nuk kanë aftësi për të parandaluar dhunën shokë me shokë që shfaqet jashtë kufijve të klasës nga një numër i vogël nxënësish kundruall shumicës që sillet mirë. Ndonëse ndëshkimi fizik është i ndaluar sipas Ligjit për Arsimin Para-Universitar, mësimdhënësit nuk janë trajnuar për përdorimin e formave alternative të disiplinës, të njohura ndërkombëtarisht, për tu përballur me rastet e dhunës shokë me shokë dhe ngacmimet.

Disa autoritete shkollore, të frustruar nga paaftësia e tyre për të mbrojtur detyrimet e veta, janë drejtuar kah angazhimi i kompanive të sigurimit nga jashtë për të mbajtur nën kontroll dhunën në oborret e shkollës. Problemet gjithashtu janë përkeqësuar nga rritja dramatike e abuzimit me substanca narkotike në shkolla dhe shumë afër tyre.

Qasja tradicionale, autoritare në arsim mbetet një fenomen i përhapur gjerë dhe shpesh herë përmendet nga nxënësit si njëra nga arsyt kryesore se pse mësimdhënësit e tyre drejtohen kah dhuna. Paaftësia e qeverisë për të zbatuar ligjin ekzistues, që do të krijonte një atmosferë më të përndritur shkollore, ka krijuar situatën ku shkollat nuk ofrojnë mjedis të sigurt dhe pozitiv për fëmijët.

Propozimi ynë parësor është që të vlerësohet se sa është aktualisht e përhapur dhuna ndaj fëmijëve në hapësirat shkollore, me qëllim që shkollat të bëhen vende të sigurta për fëmijët, me kushte të favorshme për mësim. Mbi të gjitha asnjë strategji që mëton të luftoj kundër dhunës nuk mund të ketë sukses nëse ata që e kanë për detyrë që t'i mësojnë fëmijët rreth jo-dhunës, respektit të ndërsjellë, barazisë gjinore dhe vetëdijes sociale nuk kanë vullnet që t'i ndjekin vet këto parime. Dialogu me prindër, që vet janë të dhunshëm në shtëpi karshi fëmijëve, nuk mund të nis nga institucionet edukative, derisa ata vet nuk përvetësojnë politika të rrepta të mos tolerancës ndaj ushtruesve të dhunës në hapësirat shkollore.

Shkollat ofrojnë një suazë unike në shoqëri, ku rrethi dhe modeli i dhunës mund të shkatërrohen. Në shkolla, fëmijët duhet të mësohen se si t'i zgjidhin problemet me anë të komunikimit, respektit reciprok dhe masave të padhunshme. Ky është hapi i parë drejt ndryshimit të qëndrimeve të ngulitura, të cilat në përgjithësi e konsiderojnë dhunën si të pranueshme në shoqëri.

PËRKUFIZIMET

Dhuna: "...përdorim i qëllimshëm i forcës fizike ose i fuqisë, i kërcënimit ose i përdorimit të saj real kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, që rezulton ose ka gjasa të mëdha që të rezultojë në lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, zhvillim të cenuar ose privim".

Abuzimi i Fëmijëve: "Abuzimi ose keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues apo shfrytëzimin tregtar ose çdo shfrytëzim tjetër, që rezulton në dëmtim aktual ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushtet".

Ndëshkimi trupor përkufizohet nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijës si "çdo ndëshkim, në të cilin përdoret forca fizike, me synimin për të shkaktuar një shkallë të caktuar dhimbjeje apo paretë, sado të lehtë". Në veçanti, ndëshkimi trupor në shkollë "mbulon dënimet zyrtare të nxënësve të shkollave për sjellje jo të mirë, që përfshijnë goditjen e nxënësit disa herë me një ceremoni në përgjithësi metodike dhe të paramenduar".

Dhuna psikologjike-emocionale është e përkufizuar si dëmtim i shëndetit të fëmijës, përfshirë pasojat mentale, morale, fizike ose shkaktim të vështirësive në zhvillimin e tyre social. Këto lloje të veprimeve ndikojë në personalitetin e fëmijës pasi ata janë të kërcënuar, frikësuar, sulmuar, dhe aktet e tjera të qëllimshme negative që janë të orientuara ndaj një fëmije nga një tjetër fëmijë ose një grup fëmijësh. Këto veprime përfshijnë "kufizimin e lëvizjes, modelet e përcimit, denigrimin, viktimizimin, kërcënimin, frikësimin, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jo-fizike trajtimit armiqësor apo refuzues".[†]

Ngacmimi nga bashkëmoshatarët është një shprehje që i referohet si dhunës fizike ashtu edhe asaj psikologjike. Shpesh herë manifestohet me ngacmimin e shokëve, për shembull, kur një apo disa nxënës sulmojnë fizikisht një nxënës, e përqeshin atë, e përjashtojnë nga shoqëria e tyre dhe provojnë ta bëjnë të ndihet fajtorë ose keq për veten e vet. Zakonisht, ngacmimi është "kur një nxënës bezdiset vazhdimisht në një mënyrë të ligë dhe lënduese".

Dhuna seksuale me përkufizim është "çdo akt seksual, tentim për të marrë një akt seksual, komentet e padëshiruara seksuale apo afrimet, ose të drejtuara ndryshe, kundër seksualitetit të personit duke përdorur detyrimin, nga çdo person pa marrë parasysh lidhjet e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por jo të kufizuar në shtëpi dhe punë".

KONTEKSTI DHE SFONDI

Për të kuptuar si mbizotërimin e dhunës në shkollat e Kosovës ashtu edhe pranimin e gjerë social të formave të ndryshme të dhunës që ndodhin, duhet që ta shikojmë problemin në një kontekst më të gjerë shoqëror. Shoqëria ka kaluar nëpër ndryshime dramatike që prej përfundimit të konfliktit në vitin 1999. Ekspozimi ndaj armiqësive dhe dhunës në jetën e përditshme gjatë një periudhe të gjatë kohore i ka bërë kosovarët elastik dhe mospërfillës ndaj kësaj, së paku në nivelin sipërfaqësor.

Në sistemin paralel arsimor të viteve të 90'ta, askush nuk konsideronte qortimin e mësimdhënësve që përdornin dhunën për të disiplinuar fëmijët e padisiplinuar. Ekzistonte një ndjenjë e përgjithshme se mësuesit dhe personeli shkollor tashmë po sakrifikonin shumë, duke vazhduar procesin mësimor në kohëra shumë të rrezikshme dhe të vështira dhe se nuk duhej të kritikoheshin. Megjithatë, roli i mësimdhënësve si martirë dhe nderimi me të cilin trajtohej shkolla si institucion brenda shoqërisë në përgjithësi, u zhduk kur Kosova u vendos nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Arsimi u reformua nga ekspertët ndërkombëtarë, të sjellë nga jashtë, dhe njohuritë e edukatorëve vendorë u injoruan.

Personelit mësimor iu ofruan trajnime të shpejta për metodat e reja të mësimdhënies, që ishin të përqendruara më shumë te fëmijët dhe puna në grupe dhe u kërkuar që të braktisnin metodat tradicionale, autoritare që i kishin përdorur përgjatë gjithë karrierës së tyre. Fushatat e ndryshme të drejtuara kah fëmijët ishin nisur me qëllim të edukimit të tyre për të drejtat e veta, duke theksuar, për herë të parë, se ndëshkimi fizik ishte i papranueshëm.

Përderisa reformat ishin të domosdoshme dhe qëllim mira, ato u zbatuan pa asnjë debat publik. Shumë kosovarë ndjenë se këto ligje dhe rregullore ishin imponuar ndaj tyre dhe paraqitnin zbehje të vlerave tradicionale që po minonin respektin për mësimdhënësit. Kosova është një shoqëri tejet tradicionale, ku ekziston një hierarki e definuar qartë sociale dhe ata që janë në maje ushtrojnë fuqinë dhe kontrollin përmes kërcënimeve të dhunës ndaj atyre që ndodhen në shkallët më të ulëta. Si rezultat, gjatë hulumtimit tonë, kemi gjetur se prindërit, mësimdhënësit dhe fëmijët nuk janë ende në gjendje që të përcaktojnë se çfarë përbën dhunë dhe në shoqëri në përgjithësi ka një pranim të përgjithshëm, se një formë e saj luan rol të duhur në edukimin e fëmijëve. Kësisoj, idetë e reja edukative kanë tingëlluar si të huaja për prindërit dhe mësimdhënësit. Derisa ligjet për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve si nga dëmtimi fizik ashtu edhe nga ai psikologjik janë miratuar, marrë në tërësi zbatimi i tyre ka dështuar. Është një situatë që reflekton qëndrimet e përgjithshme sociale kundruall dhunës së

drejtuar ndaj grupit më të lëndueshëm në shoqëri dhe nënkupton se institucionet nuk i japin përparësi mirëqenies së fëmijëve.

NDËRTHURJET E DHUNËS

Përdorimi i dhunës si mjet për disiplinimin, ndëshkimin dhe përmirësimin e sjelljeve të fëmijës ka qenë një metodë e përdorur gjatë dhe në shkallë të gjerë në shoqërinë kosovare dhe bazuar në hulumtimin tonë, vazhdon të jetë kështu. Përgjithësisht besohet se ndëshkimi fizik do t'ia mësojë fëmijës dëgjueshmërinë, respektin për autoritetin dhe më e rëndësishmja do t'ia ndalojë sjelljen e keqe në të ardhmen. Efekti që ky ka në mirëqenien e fëmijës është anashkaluar dhe injoruar.


Hulumtimet mbi efektet e ndëshkimit fizik në zhvillimin e fëmijës tregojnë se shpeshësia dhe rreptësia e dhunës së ushtruar ndaj tyre mund të lidhet edhe me problemet e shtuara të shëndetit mendor, ankth dhe depresion, që mund të jenë të pranishme deri në moshën madhore.

Tutje, hulumtimet tregojnë se dhuna në shtëpi minon marrëdhëniet prind-fëmijë, meqë fëmija e konsideron prindin si burim të dhimbjes dhe kështu, duke dashur që ta shmang këtë, i shmang edhe kontaktet me prindërit e tij.

Dhuna çon kah mungesa e besimit dhe mbështetjes emocionale gjatë periudhës kur fëmijët janë më së shumti të varur dhe mbështetur te prindërit e tyre. Fëmijët atëherë përjetojnë izolimin e njëjtë në shkollë, nëse mësimdhënësit e tyre po ashtu përdorin dhunën. Nëse fëmijët nuk mund t'i besojnë mësimdhënësve të tyre dhe të gjejnë mbështetje në shkollë, ai ose ajo është lënë në vetmi dhe pa përkrahje.

Në kundërshtim me besimin e përgjithshëm, provat sugjerojnë se dënimi fizik nga mësimdhënësit nuk e përmirëson suksesin arsimor ose disiplinën në klasë. Fëmijët të ekspozuar ndaj dhunës tregojnë sukses të ultë akademik, janë të shpeshë nga mësimi, kanë vështirësi në mendimin abstrakt dhe kreativ, zhvillojnë sjellje anti-sociale dhe kanë një tendencë të lartë të luajnë përtacin dhe madje edhe të braktisin shkollimin në tërësi.

Pasojat më serioze të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve është "mësimi" i padashur për dhunën si mjet për zgjidhjen e problemeve dhe kontrollimin e sjelljes së të tjerëve. Elizabeth T. Gershoff, profesore dhe zhvillimit njerëzor në Universitetin e Teksasit, ka gjetur se ekziston një rrezik i mundshëm në rritje, që të rriturit, të cilët ishin viktimat të ndëshkimit fizik në moshë të re, do të përdornin dhunën ndaj anëtarëve të tyre të familjes. Kështu, duke përdorur ndëshkimin fizik si një metodë disiplinore gjoja «të padëmshme», jo vetëm që dëmtohet fëmija në afat të shkurtër, por ka pasojat serioze në periudha më të gjata. Dhuna ushqen dhunën dhe duke mos e dënuar ndëshkimin fizik



‘Për shembull kur mësuesi i bërtet – ose godet – një shok të klasës, ndjehem sikurse po më bërtet mua.... Frikësohem me të vërtetë. Aq shumë frikësohem sa që nuk guxoj të lëviz ose të hap gojën deri në fund të orës. Frikësohem se them ndonjë gjë gabim dhe atëherë mësuesi do të më bërtet mua.’

Nxënëse e klasës së gjashtë nga një shkollë në Gjilan

të fëmijëve, një cikël i dhunës mbështetet duke e miratuar atë si një mënyrë efektive për menaxhimin e konfliktit.

INSTITUCIONET

Çështja e dhunës është vështruar në mënyra të ndryshme nga institucione të ndryshme në Kosovë. MASHT ka përpiluar strategji të ndryshme dhe projekt-ligje që synojnë parandalimin e dhunës në shkolla, por është vërtetuar se ato vështirë zbatohen.

Raporti i 2007-s i ministrisë, Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar, ka pasur publicitet të konsiderueshëm. Përbëhet nga një përmbledhje e shkurtë e historisë së arsimit në Kosovë që i referohet shkatërrimit të infrastrukturës gjatë luftës, skicon situatën aktuale dhe detajon përkushtimin institucional për zhvillimin e strategjive. Megjithatë raporti nuk përfill një përkufizim kolektiv të dhunës. Në fakt, fjala «dhunë» është përdorur vetëm një herë në dokumentin e gjatë 102 faqesh dhe i referohet rritjes së kujdesit të veçantë për fëmijët që janë viktimë të dhunës, abuzimit seksual ose trafikimit, por pa përmendur në mënyrë specifike dhunën në hapësirat shkollore.

Duke iu referuar situatës aktuale, strategjia merret me identifikimin e aktorëve kryesorë dhe motivimit të tyre për të përmirësuar gjendjen aktuale të arsimit dhe përpjekjet e institucioneve relevante për ta bërë këtë nëpërmjet trajnimeve dhe me rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke i ofruar ekspertizë të huaj mësimdhënësve vendor. Strategjia shkurtimisht shtjellon programet e trajnimeve për mësimdhënësit që janë zhvilluar ndërmjet viteve 2000 dhe 2005, që kanë pas për qëllim krijimin e një qasjeje të re për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Thekson se kjo orvatje pesë vjeçare ka qenë e përqendruar kryesisht në reformimin e programit mësimor, teksteve e librave shkollore dhe metodave të mësimdhënies. Efektiviteti i programit dhe performansa e mëvonshme e mësimdhënësve nuk është vlerësuar.

Strategjia gjithashtu identifikon kontributet e institucioneve vendore dhe donatorëve në restaurimin e infrastrukturës arsimore dhe rindërtimin e objekteve të rrënuara shkollore në periudhën e pasluftës. Dokumenti as nuk e analizon e as nuk sugjeron mënyrat se si hapësira fizike mund të ndikojnë në sigurinë në shkolla dhe si mund të dizajnohen më mirë me një perspektivë për parandalimin dhe kontrollimin e incidenteve të dhunës shokë me shokë. Për më shumë, strategjia është plot me deklarata të përgjithshme dhe të paqarta deri në masën sa i tërë hulumtimi tregon se infrastruktura më e mirë rezultojnë me shërbime të cilësisë më të lartë në arsim.¹

Shkurt, strategjia më shumë përqendrohet në aspektet akademike të arsimit se sa në atë se si mund të krijohet një mjedis më i sigurt

1 Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar në Kosovë 2007-2017, fq. 29.

për nxënësit. Nuk e vlerëson situatën aktuale duke pikëzuar pengesat kryesore për përmirësim.

Mungesa e një rruge të përcaktuar qartë që synon parandalimin dhe ndalimin e dhunës ka çuar që të gjitha palët e përfshira të shmangen nga trajtimi i problemeve ballore. Kështu, numri i madh i rasteve të pa-denoncuar të dhunës injorohet. Edhe kur dhuna raportohet, nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e veçantë. Në shumë raste nxënësit hezitojnë që ti raportojnë rastet e dhunës për shkak të frikës së viktimizimit të vetvetes për shkak të denoncimit të kryesit. Ata që janë të përfshirë në sjellje të dhunshme shpesh janë të prirë që t'i frikësojnë dëshmitarët dhe i kërcënojnë ata që të mos e nxjerrin të fshehtë para drejtorit ose punonjësve të shkollës. Kjo është një çështje që është ngritur gjatë intervistës tonë me MASHT-in. Shumë raste mbeten të pa-raportuara sepse nuk ka garanci që 'pëshpëritësi' do të mbrohet.² Gjatë periudhës prej janarit deri në gusht të 2012-ës vetëm 213 raste të incidenteve të dhunshme në shkolla janë raportuar në polici, derisa bazuar në shumicën dërmuese të të intervistuarve tanë, nuk kalon dita që dikush nuk është dëshmitar ose pjesë e incidenteve të dhunës ndërmjet nxënësve. Me sa duket vetëm rastet që kanë shkuar deri te përfshirja e autoriteteve janë të regjistruara në statistika. Autoritetet shkollore kanë të drejtë që të vendosin se si do të merrem me incidentet e dhunës në hapësirat e tyre dhe nëse duhet përfshirë policinë ose jo, varësisht nga ashpërsia e incidentit.³

Emërimi i Drejtorëve Komunal të Arsimit (DKA-ve) sikurse edhe i drejtorëve të shkollave është tepër i politizuar. Shumë drejtorë haptazi janë të lidhur me partitë politike në pushtet në qeverinë lokale dhe qendrore. Emërimet e tyre pothuajse kurrë nuk bëhen sipas meritave. Si rezultat, shumë prej tyre bëjnë përpjekje për të fshehur ose minimizuar shkallën e dhunës në shkollat e tyre, në mënyrë që të mos krijohet një perceptim mbi paaftësinë e tyre si udhëheqës. Ata kështu tentojnë që të krijojnë një përshtypje të qeverisjes së mirë në komunitetet e tyre përkatëse, që megjithatë është larg nga e vërteta.

PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR

Kjo pjesë e raportit paraqet përmbledhjen e ligjeve të miratuara që merren drejtpërdrejtë ose tërthorazi me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve.⁴ Ligjet që janë miratuar që prej përfundimit të konfliktit janë përpiluar nga këshilltarët ndërkombëtarë. Edhe pse ato janë të bazuara në praktikat më të mira, mungesa e pronësisë vendore vështirëson

² Intervistë e IKS-së me zyrtarin e MASHT-it, 7 nëntor 2012, Prishtinë.

³ Intervistë e IKS-së me zyrtarin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, 6 qershor 2012, Prishtinë.

⁴ Shih Shtojcën I për listën e ligjeve relevante.

zbatimin e tyre dhe kjo mungesë e përparimit i bën palët që të kërkojnë zgjidhje në përpilimin e pjesëve të reja të legjislacionit në vend se t'i zbatojnë ato ekzistueset. Kjo ka shpjerë deri te mbingarkesa shumë shtresore e politikave dhe legjislacionit, të cilat janë miratuar ose presin miratimin zyrtar nga qeveria.

Prezantimi i kuadrit ligjor nis me aktin më të lartë juridik në Kosovë, që është Kushtetuta. Në nenin 47, E Drejta për Arsimin, siguron “për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar...”⁵. Neni 50 mbi Të Drejtat e Fëmijës përshkruan parimet e përgjithshme për të drejtën e fëmijës në “mbrojtje dhe kujdes të domosdoshëm për mirëqenien e tyre” dhe saktëson se “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve”.⁶

Krahas Kushtetutës janë edhe tri ligje kryesore që trajtojnë veçanërisht të drejtat e fëmijëve për arsim, duke u përqendruar në nivelin fillores dhe të mesëm. Në terma të përgjithshëm ato synojnë të mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe të ndalojnë dhunën në shkolla dhe në disa shkallë dënojnë çdo paafësi të individëve dhe institucioneve relevantë për mos marrje të masave të duhura në lidhje me këtë. I pari, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, i cili është miratuar më 17 dhjetor 2004, nga atëherë Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes që punonin nën administrimin e UNMIK-ut, ka krijuar detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorëve të Arsimit duke përfshirë mes tjerash urdhrin për të marrë “masa disiplinore të shqiptuara ndaj nxënësve, studentëve, mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të institucionit”.⁷ Neni 5 i të njëjtit ligj nënvizon kompetencat e Inspektorëve të Arsimit përmes të cilave nëse ata konstatojnë “se personi i autorizuar i institucionit arsimor, ose punëtori tjetër ka bërë kundërvajtje: delikt fizik, moral, ekonomik, korrupsion, fyerje në baza nacionale, fetare ose ve për tjetër penale”, atëherë ata duhet ta “t’ia paraqesin kërkesën organit kompetent për fillimin e procedurës”.⁸

I dyti, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, që është miratuar më 21 maj 2008, i jep disa kompetenca të caktuara komunave në nenin 5. Këto kanë të bëjnë me “mbikëqyrjen dhe inspektimin e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i; [...]përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si

5 Kushtetuta e Rep. së Kosovës, Neni 47, E drejta për Arsim.

6 Kushtetuta e Rep. së Kosovës, Neni 50, Të drejtat e Fëmijëve.

7 UNMIK, Ligji Nr. 2004/37 për Inspektimin e Arsimit në Kosovë, neni 4, nënparagrafi 4.3(f).

8 UNMIK, Ligji Nr. 2004/37 për Inspektimin e Arsimit në Kosovë, neni 4, nënparagrafi 5.4(f).

dhe masat disiplinore; [...]monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu si përcaktohet nga legjislacioni...”.⁹

I treti, Ligji për Arsimin Para-Universitar, që është miratuar më 29 gusht 2011, është pjesa më e fundit e legjislacionit që ka të bëjë me nxënësit. Përfshin disa nene që merren me mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e dhunës sikurse edhe detyrat e palëve të përfshira. Neni 4 i këtij ligji ofron dispozita për mbrojtjen e grupeve të cënueshme dhe detyron gjithë personelin në institucionet arsimore që të “ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese”.¹⁰ Tutje ndalon “ndëshkimin fizik apo çfarëdo forme tjetër të ndëshkimit nënçmues”.¹¹ Neni 8 gjithashtu ofron disa udhëzime për inspektimin arsimor duke theksuar se pas raportit të inspektorit, nëse dhe kur mangësitë e identifikuar nuk janë adresuar atëherë “Ministria mund të ndërpresë punën e institucioneve arsimore dhe aftësuese të cilat nuk janë të licencuara apo veprojnë në ambiente të pasigurta dhe të pashëndetshme”.¹²

Ligji po ashtu thekson se ministria mund të “udhëzojë komunën që të ndërpresë marrëdhënien e punës së një mësimdhënësi që është punësuar në kundërshtim me kriteret e specifikuar në këtë ligj, ose është përjashtuar nga puna për shkak të kushteve mjekësore ose urdhrat të gjykatës apo dispozitat e këtij ose ligjeve të tjera në fuqi kërkojnë një gjë të tillë”.¹³ Megjithatë nuk siguron ndonjë mekanizëm nga i cili mund të ndërpritet puna e ndonjë institucioni apo personi arsimor, sikurse mësimdhënësi, drejtori, apo çfarëdo i punësuar tjetër që kryen dhunë ose ndonjë vepër tjetër nënçmuese ndaj fëmijëve në shkolla. Neni 20 ofron një dispozitë që megjithatë i jep përgjegjësi ekzekutive drejtorit të një institucioni arsimor për menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë “caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve ... detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit ...”¹⁴

Përpos dispozitave kushtetuese, sikurse edhe këtyre ligjeve

⁹ Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Neni 5.

¹⁰ Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 4, Paragrafi 1.

¹¹ Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 4, Paragrafi 2.

¹² Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 8, Paragrafi 6, nënparagrafi 6.1.

¹³ Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 8, Paragrafi 6, nënparagrafi 6.2.

¹⁴ Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 20, Paragrafi 2.



Mjedisi, në të cilin nxënësit kalojnë pjesë të rëndësishme të jetës së tyre, në vend se të ofroj një atmosferë pozitive të favorshme për mësim dhe zhvillim personal, aktualisht i ekspozon ata ndaj dhunës, e cila mund të jetë potencialisht e dëmshme, qoftë për viktimën apo thjeshtë dëshmitarin, sikurse edhe për shoqërinë si tërësi.

specifike, ekzistojnë edhe aktet nënligjore, siç janë Udhëzimet Administrative (UA-të) që lëshohen nga MASHT-i, të cilat merren drejtpërdrejtë ose tërthorazi me çështjen e të drejtave të fëmijëve dhe dhunës ndaj tyre. Por, nga 243 UA-të që janë lëshuar nga MASHT-i ndërmjet viteve 2002 dhe 2013, vetëm pesë prej tyre përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë. Ato janë, UA për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar i lëshuar më 23 mars 2005, UA për Procedurat administrative të inspektimit në institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore, lëshuar më 4 prill 2005 dhe UA për Ndalimin, ndërprerjen e punës dhe inicimin e procedurës disiplinore ndaj mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore, lëshuar më 28 shtator 2005, pastaj një për Kodin e Etikës për Vlerësimin e Nxënësve, lëshuar më 23 dhjetor 2011 dhe një tjetër për Themelimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Prindërve të Kosovës (KPK) lëshuar më 31 dhjetor 2012.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij projekti hulumtues ishte vlerësimi se sa është e përhapur dhuna në shkolla për moshat 11 deri në 15 vjeç. Fushata të shumta për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat elementare të fëmijëve si dhe rëndësinë e sigurimit të një mjedisi të sigurt dhe harmonik për mësim të nxënësve janë ndërmarrë gjatë dekadës së kaluar. Grupet e synuara të këtyre fushatave kanë përfshirë nxënësit, mësimdhënësit dhe administratorët e shkollave. Megjithatë gjendja aktuale e sigurisë në shkolla lë shumë për të dëshiruar. Videot e mësimdhënësve duke rrahur nxënësit në klasë janë shpërndarë, ku njëra prej tyre, siç është përmendur më sipër, ka arritur më shumë se 344,000 klikime.¹⁵ Të dhëna për përlëshjet nxënës-nxënës në shkolla janë raportuar në media.¹⁶ Mjedisi, në të cilin nxënësit kalojnë pjesë të rëndësishme të jetës së tyre, në vend se të ofroj një atmosferë pozitive të favorshme për mësim dhe zhvillim personal, aktualisht i ekspozon ata ndaj dhunës, e cila mund të jetë potencialisht e dëmshme, qoftë për viktimën apo thjeshtë dëshmitarin, sikurse edhe për shoqërinë si tërësi.

METODOLOGJIA

Për të vlerësuar gjendjen e dhunës në shkolla janë përdorur si metoda cilësore ashtu edhe ajo sasimore dhe i gjithë projekti hulumtues është ndarë në dy faza. Mbledhja e tërësishme e të dhënave është re-

¹⁵ <http://www.youtube.com/watch?v=vPbglNapZac>.

¹⁶ School violence in Kosovo turns deadly, 08.06.2011, SETimes. Dhuna e nxënësve, fenomen i shoqërisë tradicionale, 17.03.2013, Evropa e Lirë.

alizuar në 19 shkolla fillore.¹⁷ Prej tyre 13 janë në Prishtinë, 4 në Gjiilan, 1 në Korreticë të Poshtme dhe 1 në Podujevë. Gjithsej 458 nxënës janë përgjigjur në anketa, të cilat janë shpërndarë në Prishtinë, derisa të dhënat nga shkollat tjera janë grumbulluar me intervista personale. Meqë grupmosha e nxënësve ishte 11–15 vjeç nuk ka pasur nevojë për ndihmë në plotësimin e anketave, sepse ata ishin në gjendje që t'i plotësonin ato vetë. Përderisa ky numër nuk përfaqëson tërë shtresën e nxënësve të kësaj grupmoshe, ai është tregues i mjedisit dhe gjendjes së dhunës në hapësirat shkollore të Prishtinës.¹⁸

Faza e parë, e realizuar në shtator të 2012–ës, ka përfshirë hulumtimin paraprak nga zyra për të parë fondin e ligjeve të miratuara që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjatë kësaj faze, janë intervistuar nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave si dhe zyrtarë relevantë të institucioneve që kanë rol ose hise në sigurinë e nxënësve. Në tërësi, 71 fëmijë të klasave 6–9¹⁹ janë intervistuar prej të cilëve 39 ishin djem dhe 32 vajza. Gjithashtu është mbajtur një fokus grup me të njëjtën grupmoshë, që është përbërë nga 11 fëmijë nga tri shkolla të ndryshme. Po ashtu, janë anketuar 100 nxënës nga shkolla fillore Hilmi Rakovica në Prishtinë.

Faza e dytë e hulumtimit, e realizuar në maj të 2013–ës, ka përfshirë mbledhjen e të dhënave duke anketuar tri shkolla tjera në Prishtinë për të matur aspektin sasior të përhapjes së dhunës. Për dallim prej 100 anketave që ishin shpërndarë në fazën e parë, në këto të fazës së dytë janë mbledhur edhe të dhënat demografike të nxënësve si gjinia, mosha dhe klasa. Ndarja gjinore dhe e klasave është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Gjinia dhe klasa e fëmijëve të anketuar

School	Gender		Grade				
	Male	Female	N/A	VI	VII	VIII	IX
Naim Frasheri	46	30	6	–	–	41	41
Gjergj Fishta	38	55	3	–	31	40	25
Elena Gjika	96	76	7	69	–	35	76
Total	181	161	16	69	31	116	142

¹⁷ Mostra mbulon vetëm shkollat shqipe dhe fëmijët shqiptarë.

¹⁸ Në Prishtinë janë 59 shkolla fillore, 44 në Gjiilan, 1 në Korreticë të Poshtme dhe 62 në Podujevë. Statistikat e Arsimit Kosovar 2012/2013, fq. 14.

¹⁹ Nivelet e sistemit të arsimit në Kosovë (sipas ISCED 97): shkollimi fillor (klasat 1–5), shkollimi i mesëm i ulët (klasat 6–9), shkollimi i mesëm i lartë (klasat 10–13).

TË GJETURAT E HULUMTIMIT

Hulumtimi ynë tregon se prania e dhunës në shkollat e Prishtinës është në nivele mjaft serioze që mund të paraqesin shqetësime të vërteta. Dhuna nxënës-nxënës shfaqet kryesisht në formën e ngacmimit, kërcënimeve dhe vandalizmit. Dhuna e shfaqur nga mësimmshënësit në klasa ndodh në baza ditore, si në formën verbale ashtu edhe me sulme fizike. Zbehja e respektit për autoritetin e mësimmshënësve dhe administratën e shkollës si tërësi nga nxënësit duket të jetë një çështje shtesë që vështirëson krijimin e një mjedisi pozitiv, të respektueshëm dhe bashkëpunues për mësim.

Ky raport shfaqjen e dhunës në shkolla e ndan në dy fusha: (1) dhuna që ndodh në klasa, ku kryesit kryesorë janë mësimmshënësit dhe (2) dhuna që ndodh në oborr ku kryesit janë vet fëmijët. Kjo ndarje është bërë si rezultat i përgjigjeve në anketa dhe do të ndihmoj në paraqitjen e rezultateve të hulumtimit në një mënyrë të qartë dhe qëndrueshme.

PËRKUFIZIMI I DHUNËS

Ndëshkimi fizik si pjesë e rëndësishme e edukimit të fëmijëve, me qëllim të përshtatjes dhe korigjimit të sjelljeve të padëshiruara të një fëmijë, tradicionalisht ka qenë e përdorur gjerësisht nga prindërit dhe mësuesit njësoj dhe për një kohë të gjatë nga shoqëria është perceptuar si një metodë e pranueshme e disiplinës. Gjatë procesit të intervistave, qëllimi ka qenë që të mblidhen informatat se si shihet sot ndëshkimi fizik. Pyetjet gjysmë të strukturuar u kanë lejuar të anketuarve që të elaborojnë mbi pyetjet e parashtruara dhe të na ofrojnë një provë më të thellë mbi perceptimet për përdorimin e dhunës fizike si një mjet disiplinor.

Prej 21 prindërve të intervistuar, 70 për qind prej tyre e kanë konsideruar si të favorshme ndonjë formë të ndëshkimit fizik në shkollë. Kur janë pyetur se çfarë përbën një veprim i dhunshëm, shumica kanë dhënë definicione që përfshijnë si dhunën fizike ashtu edhe atë psikologjike.

Asnjëri prej prindërve nuk ka konsideruar se ndarja e bazuar në statusin social ose prejardhjen (p.sh. rural, urban) mund të jetë prej elementeve të mundshme të diskriminimit në klasë. Megjithatë, shumica e prindërve kanë falur ndonjë akt të dhunës si përgjigje për të përmirësuar sjelljen e fëmijës së padisiplinuar.

Një prind, kur është pyetur që të përkufizoj dhunën ka thënë, “një shuplakë, shkelm ose fjalët qortuese nuk janë dhunë” dhe se ajo “nuk do të zemërohej nëse fëmija e saj vjen nga shkolla e rrahur rreptë, nëse është sjellë keq në shkollë.” Shumë prindër kanë përmendur faktin se, si fëmijë, edhe ata vet janë rrahur në shkollë, por se “këtë e

kanë merituar” dhe se “nuk ka qenë fundi i botës”.²⁰

Mësimdhënësit, në anën tjetër, gjatë intervistave, temës së të drejtave të fëmijëve dhe dhunës i janë qasur në mënyrë mbrojtëse. Shumica e mësimdhënësve (5 nga 9) kanë deklaruar se përqendrimi në rritjen e vetëdijes në mes fëmijëve përgjatë dekadës së fundit ka shkaktuar më shumë dëme se sa të mira me mënyrën se si është ofruar nga organizatat që merren me të drejtat e fëmijëve. Argumenti i mësimdhënësve ka qenë se fëmijët kanë qenë të mbi-fuqizuar si rezultat i fushatave, që ka çuar deri te zbehja e respektit për ta dhe te dështimi për të përçar porosinë të fëmijët se ata nuk mund të sillen siç kanë dëshirë. Një mësimdhënëse ka përmbledhur ndjenjat e saja lidhur me keqkuptimet që kanë krijuar këto fushata; “Nëse vetëm e ngre zërin pak, ata [fëmijët] e konsiderojnë këtë dhunë”.²¹ Të gjithë mësimdhënësit kanë mohuar përdorimin e dhunës fizike për të vendosur rend në klasë, derisa disa e kanë pranuar se kjo ka qenë një metodë e përdorur në të kaluarën nga “disa prej kolegëve të tyre”.²²

Në dy shkolla në Prishtinë, mësimdhënësit nuk kanë hezituar që të përdorin gjuhë ofenduese dhe ti thumbojnë me fjalë nxënësit e tyre në praninë e hulumtuesve të IKS-së. Në Elena Gjika, derisa nxënësit po i plotësonin pyetësorët, një mësimdhënëse vazhdimisht “paralajmëronte” hulumtuesen se të gjithë këta nxënës të klasës së 6-të janë rrenacakë dhe se nuk duhet besuar atyre në asnjë rrethane dhe nuk ka hezituar që të këtë ta thotë publikisht edhe para klasës së tij, të përbërë nga nxënës 11 vjeçar. Në shkollën fillore Gjergj Fishta, derisa hulumtuesit po prisnin që të shpërndanin pyetësorët, mësimdhënësi kujdestar i asaj dite me shuplaka e shkelma po i deftyronte nxënësit që të shkonin nëpër klasat e tyre. Mosrespektimi i dukshëm për urdhrat e dhëna me bërtitme dhe sulmi fizik i mësimdhënësit ndaj fëmijëve ishin mjaft të theksuara, duke nënvizuar se përdorimi i forcës ishte i zakonshëm, i padobishëm dhe jo efektiv. Gjergj Fishta është shkolla në të cilën është incizuar videoja e mësimdhënësit që rrihte me shuplaka dhe goditje nxënësit në vitin 2011, e që ishte shpërndarë online (rasti i përmendur më sipër).

DHUNA NË KLASA

Pas intervistave të bëra gjatë shtatorit të 2012-ës, 100 anketa janë shpërndarë në shkollën Hilmi Rakovica. Prej numrit të përgjithshëm të anketuarve, 42 për qind kanë thënë se ata kanë marrë ndëshkime të përgjithshme derisa 42 për qind kanë theksuar se ata janë ndëshkuar për shkak se nuk kanë mësuar. Pesëdhjetë për qind të nxënësve kanë

20 Intervistë e IKS-së me një prind nga Prishtina, 22 shtator 2012.

21 Intervistë e IKS-së me mësimdhënëse në ‘Elena Gjika’, 7 qershor 2012.

22 Intervistë e IKS-së me mësimdhënëse në ‘Elena Gjika’, 7 qershor 2012.

raportuar se janë ndëshkuar për shkak të vonesave. Forma e ndëshkimit nuk është specifikuar.

Në rastet ku ndëshkimi fizik ishte përdorur, nxënësit dhanë arsytet e mëposhtme që i kishte shtyre mësimdhënësit e tyre kah përdorimi i dhunës: 83 për qind kanë raportuar se mësimdhënësit e tyre i rrahin nxënësit për shkak se janë të zhurmshëm në klasë, derisa 48 për qind theksuan se mësimdhënësit i rrahin fëmijët, të cilët i konsiderojnë se nuk po mësojnë mjaftueshëm. Tutje, 34 për qind të nxënësve njoftuan se mësimdhënësit kanë përdorur ndëshkim fizik sepse ata ishin në disponim të keq, derisa 41 për qind ndjenë se mësimdhënësit i janë drejtuar nxënësve në mënyrë përçmuese dhe ofenduese. Përveç kësaj, 32 për qind të nxënësve thanë se kanë ndjerë se janë diskriminuar nga mësimdhënësit e tyre në ndonjë mënyrë, por vetëm 17 për qind kanë konsideruar se kjo është bërë për shkak të prejardhjes së tyre sociale. Sa i përket ngacmimit seksual, 16 për qind të nxënësve kanë thënë se ata vet kanë përjetuar ose dëgjuar për ngacmimin seksual ndaj të tjerëve nga mësimdhënësit.

Tabela 2. Përgjigjet e fëmijëve në pyetjet lidhur me format e ndryshme të dhunës (n=100, Shkolla: Hilmi Rakovica)


Pyetja	Përgjigja pozitive
A jeni dënuar në shkollë?	42,3%
Jam dënuar në shkollë për shkak të mos mësimi.	42,2%
Jam dënuar në shkollë për shkak të vonesës.	50,0%
Mësimdhënësit/kujdestarët zakonisht vëzhgojnë sjelljen tënde dhe i informojnë prindërit	94,0%
Mësimdhënësit të drejtohen me zhargon pezhorativ dhe ose nënçmues	40,6%
Mësimdhënësit të diskriminojnë ose të dënojnë.	31,6%
Mësimdhënësit të diskriminojnë ose të dënojnë shkak i situatës tënde ekonomike.	17,3%
Mësimdhënësit të rrahin kur bën zhurmë.	82,7%
Mësimdhënësit të rrahin për shkak se nuk mëson.	47,5%
Mësimdhënësit të rrahin kur janë në disponim të keq (nervoz).	33,7%
Mësimdhënësit të flasin rreth temave të religjionit?	55,3%
A ke përjetuar ose dëgjuar për raste të ngacmimit seksual nga mësimdhënësit	15,8%
Students address teachers offensively in your school	50,0%

Përpos anketimit të shtatorit të 2012-ës në Hilmi Rakovica, janë realizuar edhe tri anketime shtesë në maj të vitit 2013 në tri shkolla tjera të Prishtinës. Qëllimi i tyre ka qenë mbledhja e të dhënave sasiore shtesë mbi përhapjen e dhunës në mjediset arsimore.

Në këtë rreth, nxënësit janë pyetur që të tregojnë saktësisht se çfarë forme e ndëshkimit është përdorur nga mësimdhënësit. Pyetja ofronte një listë me pesë forma të ndryshme të ndëshkimit dhe nga nxënësit është kërkuar që t'i rendisin ato nga 1 (më së shpeshti e përdorur nga mësimdhënësit) deri në 5 (asnjëherë e përdorur nga mësimdhënësit). Nxënësve i është dhënë mundësia që të përmendin edhe forma tjera

të ndëshkimit që nuk kanë qenë të përfshira në listën e ofruar. Prej 358 nxënësve, 300 i janë përgjigjur pyetjeve derisa 58 tjerë nuk janë përgjigjur. 53 nxënës renditën shpeshtësinë e formave të ndryshme të listuara. Grafiku 1.1 tregon format më të shpeshta të ndëshkimit fizik të përdorur nga mësimdhënësit.

Grafiku 1.1 Përgjigjet në pyetjen ‘Cilat janë format më të shpeshta të ndëshkimit?’



Nga grafiku i sipërm shohim se tërheqja e veshit ose e flokëve kanë qenë format më të shpeshta të ndëshkimit fizik që kanë ndodhur në klasë, e përcjellë menjëherë nga goditja dhe shpulla në kokë. (Shih shtojcën për listën e rasteve individuale të dhunës të dhëna gjatë intervistave me nxënësit.)

Format e dhunës që më së shpeshti janë përmendur nga nxënësit e që janë përdorur nga mësimdhënësit për të vendosur rend në klasë dhe për të dënuar nxënësit për sjellje të keqe janë ato forma “të buta” që gjatë fazës së intervistimit janë lënë anash meqë janë konsideruar si masa të pranueshme dhe se “nuk kanë paraqitur dhunë të vërtetë”, sikurse tërheqja e veshit apo goditja.

44 nxënësit që kanë zgjedhur opsionin “tjetër” kanë paraqitur forma të ndryshme të ndëshkimit që ata i kanë përjetuar e që nuk kanë figuruar në listën që i është ofruar atyre. Format e identifikuara nga ky grup i studentëve janë të paraqitura më poshtë në Tabelën 3.

Përdorimi i gjuhës poshtëruese dhe ofendimet e drejtuara kah fëmijët sikurse edhe mësimdhënësit që bërtasin me qëllimin që t’i frikësojnë dhe poshtërojnë fëmijët në prani të shokëve të tyre janë format tjera më të përhapura të dhunës me të cilat ballafaqohen nxënësit në baza ditore në klasa. Shprehjet poshtëruese që përdoren më së shpeshti nga mësimdhënësit gjatë drejtimit të tyre kah nxënësit janë të paraqitura në Tabelën 4.

Tabela 3. Format tjera të masave disiplinore që përdoren nga mësime dhënësit

Forma e ndëshkimit	Shpeshësia
Përgjithësimi nga klasa	8
Të qenit pre e bërimitës	8
Tërheqja e vërejtjes në mënyrë verbale	5
Humbja e notave	5
Prindërit e kontaktuar	4
Mos lejimi i daljes në pushim	4
Ofendime verbale	3
Dënime tjera jo-fizike	2
Pyetja e menjëhershme me gojë	1
Thyerja e notës së sjelljes	1
Dërgimi te drejtori	1
Qortimi	1
Qëndrimi me një këmbë	1




Tabela 4. Emrat nënçmues që përdoren zakonisht nga mësime dhënësit ndaj nxënësve

Ofendimi	Shpeshësia
Budall	73
Trullan, trullavice, trullajke	32
Majmun	29
Kali	22
Idiot	19
Pis	16
Hajvan	11
Lopë	8
Magar	7
Dreq	5

Format e dhunës që më së shpeshti janë përmendur nga nxënësit e që janë përdorur nga mësime dhënësit për të vendosur rend në klasë dhe për të dënuar nxënësit për sjellje të keqe janë ato forma “të buta” që gjatë fazës së intervistimit janë lënë anash meqë janë konsideruar si masa të pranueshme dhe se “nuk kanë paraqitur dhunë të vërtetë”, sikurse tërheqja e veshit apo goditja.

DHUNA NË OBORR

Dhuna shokë me shokë në formë të ngacmimit, rrahjes dhe abuzimit verbal janë përmendur si pjesë të përvojës së përditshme në shkollë nga të gjithë fëmijët e intervistuar. “Është sukses i madh nëse kalon një ditë dhe nuk sheh një rrahje”. Përgjigja e këtij nxënësi të klasës së 7-të në pyetjen nëse ka rrahje të nxënësve në shkollën e tij ilustron seriozitetin e problemit dhe nevojën për të gjetur masa efektive parandaluese për të ofruar një mjedis të sigurt arsimor për fëmijët.

Kur fëmijët janë pyetur nëse ata janë ngacmuar, ata kanë ngurruar që të pranojnë se vet kanë qenë të ngacmuar, ose të kenë qenë viktimë e sulmit fizik. Ata kanë qenë të prirë që të theksojnë raste që u kanë ndodhur shokëve të tyre ose që i kanë parë në klasë ose oborr të shkollës. Pyetësi i ka dhënë anonimitet fëmijëve dhe ka ofruar matje sasiore të shtrirjes dhe formave të dhunës që janë përjetuar dhe parë nga fëmijët.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara përmes intervistave,

kemi identifikuar tetë forma më të përmendura të dhunës nxënës-nxënës, të cilat i kemi përdorur si kategori të ndara kur janë përgatitur pyetjet e anketës. Pyetjet që janë parashtruar janë si në vijim.²³

Gjatë javës së kaluar sa herë ...

- (P.1.1. - Përgojimi) - je përgojuar?
- (P.1.2. - Fyerja) - je bërë objekt i talljes ose fyerjes?
- (P.1.3. - Kërcënimi) - je kërcënuar?
- (P.1.4.- Frikësimi) - je detyruar që të bësh gjëra kundër

vullnetit tënd?

- (P.1.5. - Dëmtimi) - janë vandalizuar gjërat tua?
- (P.1.6. - Përrjashtimi) - je përrjashtuar nga pjesëmarrja në


një aktivitet?

- (P.1.7. - Sulmi) - je shtyrë, penguar ose zënë?
- (P.1.8 - Ofendimi virtual) - je ofenduar ose ke pranuar porosi

ofenduese përmes sms-it ose Facebook-ut?

Fëmijët kanë mundur që të zgjedhin të përgjigjen: kurrë, njëherë, më shumë se njëherë, ose vazhdimisht.

Grafiku 1.2 Numri i fëmijëve të nënshtuar ndaj dhunës së moshatarëve (n=358)




Fyerjet, vandalizmi, përgojimi dhe sulmet janë format më të shpeshta të dhunës nxënës-nxënës. Gati një e treta e fëmijëve kanë dëshmuar se kanë përjetuar sulme fizike nga duart e shokëve të tyre, derisa 40 për qind e fëmijëve janë përballur me vandalizmin e gjërave të veta nga shokët e tyre. 12 për qind kanë theksuar se gjërat e tyre janë dëmtuar më shumë se njëherë në javë. Dy format më së shpeshti të përmendura të dhunës nxënës-nxënës që shfaqen vazhdimisht janë fyerjet dhe përgojimi. Kur lloji i dhunës nxënës-nxënës ndahet sipas


23 Shih Shtojcën III për pyetësorin e plotë në gjuhën shqipe.

gjinisë, atëherë duket se vandalizmi i gjërave si thyerja e telefonave, shqyerja e faqeve të librave ose shkelja mbi çanta është përjetuar më shumë nga vajzat sesa nga djemtë. Të gjitha llojet tjera të dhunës në mes të nxënësve shfaqen më shpesh në mesin e djemve, ndërkohë që nuk ka pas dallim domethënës mbi llojet e përdorura.

Grafiku 1.3 Shpeshtësia e dhunës në mes nxënësve, e ndarë sipas gjinisë



Grafiku 1.4 Ndarja sipas shkollave




Kur ndahen sipas shkollave, katër format më të përhapura të dhunës nxënës-nxënës janë të shpërndarë në pothuajse të njëjtin nivel -

me disa përjashtime të vogla. Vandalizmi i gjërave private, për shembull, ndodh më shpesh në Gjergj Fishta se në shkollat e tjera.

Kur pyetjet janë formuluar në mënyrë që mos t'i drejtohen drejtpërdrejt të anketuarit, por në formën nëse ata kanë parë ndonjë shok të tyre duke qenë viktimë e dhunës nxënës-nxënës, një numër më i lartë i përgjigjeve pozitive është marrë, siç ishte rasti gjatë intervistave. Grafiku 1.5 tregon se 58 për qind të anketuarve janë përgjigjur në mënyrë afirmative se ata kanë parë që shokët e tyre duke përjetuar ngacmim nxënës-nxënës, prej të cilëve 15.4 për qind kanë theksuar se shokët e tyre vazhdimisht ngacmohen ose sulmohen.

Grafiku 1.5 Ndonjë shok/shoqe a ka qenë viktimë e ngacmimit




Ne pastaj kemi kërkuar nga fëmijët që të përgjigjen në pyetje me fund të hapur, në të cilën përgjigje ata kanë mundur të rendisin mënyrat në të cilat shokët e tyre janë ngucur ose sulmuar nga moshatarët e tyre. Prej 358 nxënësve, 171 kanë dhënë përgjigje specifike. Përgjigjet më të shpeshta janë të renditura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Format e sulmeve nxënës-nxënës

Format e sulmeve	Shpeshtësia
Gjuha ofenduese	55
Shuplaka dhe rrahja	29
Tallja	15
Prekja në pjesë intime	11

Në mesin e formave tjera të renditura, por me një paraqitje më të ulët, kanë qenë përdorimi i fyerjeve sikurse “trashalug”, “gej”, “kurvë”, “po bëhesh si çikë” dhe komente tjera të ngjashme. Incidentet e raportuara si ‘prekja në pjesë intime’ në tabelën e mësipërme kanë të bëjnë vetëm me vajzat.



“Unë nuk guxoj që të intervenoj vetëm. Ata shpesh kanë thika, prandaj ne e thërrasim policinë.” Policia në komunitet shihet si një zhvillim pozitiv nga mësimdhënësit dhe drejtorët. “I kemi numrat e telefonave të dy policëve dhe ata vijnë menjëherë sa herë që i thërrasim. Ata ndonjëherë vijnë vetëm që të shohin nëse ka ndonjë problem. Ata ndonjëherë vijnë dhe flasin me nxënësit.”

Mësimdhënësi në shkollën fillore “Gjergj Fishta”

KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR SIGURINË NË SHKOLLA?

Gjatë vizitave tona në shkolla është vërejtur se aty nuk ka monitorim se kush ka qasje në këto hapësira. Një masë që mund të forconte sigurinë në shkolla dhe të parandalonte qasjen e të panjohurve do të mund të ishte futja në përdorim e uniformave të detyrueshme shkollore. Kjo do ta bënte më të lehtë dallimin e nxënësve nga fëmijët e shkollave tjera, sikurse edhe personave të huaj që nuk kanë leje që të jenë aty.



Gjatë intervistave, drejtorët e shkollave kanë ngritur shqetësimet e tyre në lidhje me rrahjet e nxënësve që ndodhin në oborr, për të cilat konsideronin se në të shumtën e rasteve janë rrahje grupe ndërmjet grupeve “rivale” të nxënësve. Asnjëra nga shkollat që janë vizituar nuk ka mbikëqyrës të oborrit të shkollës, i cili do të mund të vëzhgonte pushimin. Kur i kemi pyetur fëmijët se kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e sigurisë në oborr, 60 për qind kanë thënë se ky ishte roli i pastruesit [shih grafikun më poshtë]. Duke pasur hapësira të pambikëqyrura shkollore kanë ndodhur një numër i konfrontimeve të dhunshme ndërmjet nxënësve, të cilat në një numër rastesh kanë rezultuar me lëndime serioze të shkaktuara nga armët e ftohta, sikurse që janë thikat.

Nuk ka vëzhgues shkollore përgjegjësie e vetme e të cilëve do të ishte garantimi i sigurisë së fëmijëve në oborr të shkollës. Në shkollën Gjergj Fishta një mësimdhënësi na tha: “Unë nuk guxoj që të intervenoj vetëm. Ata shpesh kanë thika, prandaj ne e thërrasim policinë.”²⁴ Policia në komunitet shihet si një zhvillim pozitiv nga mësimdhënësit dhe drejtorët. “I kemi numrat e telefonave të dy policëve dhe ata vijnë menjëherë sa herë që i thërrasim. Ata ndonjëherë vijnë vetëm që të shohin nëse ka ndonjë problem. Ata ndonjëherë vijnë dhe flasin me nxënësit.”²⁵

Përderisa Policia në Komunitet ka qenë një zhvillim pozitiv që çon kah mjedisi më i sigurt për fëmijët dhe komunitetin në përgjithësi, mbetet ende punë për të bërë për parandalimin e dhunës në oborret e shkollave. Nuk mjafton që thjeshtë të reagohet vetëm kur ndodhin incidentet.

24 Intervistë e IKS-së, 15 shtator 2012.

25 Intervistë e IKS-së me një mësimdhënësi në Gjergj Fishta, 25 maj 2013.

Grafiku 1.6 Kush është përgjegjës për sigurinë në oborret e shkollave?**Grafiku 1.7 Sa herë gjatë vitit të kaluar ke parë armë (armë zjarri dhe/ose armë të ftohta) në shkollën tënde?**

Posedimi i armëve të ftohta, kryesisht thikave, nga grupet e nxënësve është gjerësisht e përhapur dhe ka arritur nivele alarmante. Gjatë intervistave, si nxënësit ashtu edhe mësime dhënësit kanë përmendur kërcënimin që u paraqitet nxënësve nga rritja e numrit të fëmijëve që bartin armë. Mësime dhënësit e intervistuar fajësojnë prindërit e fëmijëve për mos kontrollim të çantave të tyre para se ata të nisen për shkollë dhe nuk e ndejnë se është përgjegjësia e tyre që të merren me këtë problem.

PËRFUNDIM

Hulumtimi ynë për nivelin e dhunës në hapësirat shkollore ka treguar se fëmijët në Kosovë janë të ekspozuar ndaj saj në baza ditore. Dhuna shfaqet në forma të ndryshme dhe ushtrohet si nga mësime dhënësit ashtu edhe nga nxënësit deri në një shkallë. Legjislacioni ekzis-

ton për të trajtuar kryesit e dhunës, megjithatë nuk zbatohet në mënyrë efektive.

Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të këndshëm, të përshtatshëm për mësim, është i rëndësishëm më të madhe dhe duhet të jetë një prioritet i qeverisë. Shkollat mund të luajnë rol të rëndësishëm në thyerjen e modelit të dhunës në shoqëri duke i mësuar fëmijët që të mendojnë vetë, të përvetësojnë vlerën e respektit për të tjerët, të mos diskriminojnë dhe të përdorin komunikimin si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve. Shkollat e sigurta jo vetëm që ofrojnë dobi të menjëhershme të krijimit të mjediseve ku fëmijët mund t'i zhvillojnë në tërësi kapacitetet e tyre njohëse, të shoqërohen dhe të zhvillojnë ndjenjën e komunitetit, por kanë një ndikim të rëndësishëm afatgjatë në krijimin e qytetarisë dhe shtetit që vlerëson barazinë, komunitetin dhe integritetin individual.

Përveç rekomandimeve të ofruara për institucionet relevante më sipër, më poshtë është një listë e sugjerimeve që do të mund të zbatoheshin në nivelin e shkollave.

- Mbledhje të rregullta me prindër në klasë dhe në baza vjetore si dhe krijimi i këshillit të prindërve të shkollës.

- Mbledhje të rregullta të organeve drejtuese të shkollës.

- Drejtorët e shkollave duhet të takohen në baza mujore me Kryetarin e Komunës ose Drejtorin Komunal të Arsimit.

- Krijimi i komunitetit të shkollës me zhvillimin e aktiviteteve shtesë përtej programit mësimor, si për shembull: debatet, takimet, klubet sportive, ato të dramës dhe shërbimi në komunitet.

- Krijimi i dokumenteve zyrtare të shkruara të incidenteve të dhunës që mbulon tërë territorin e shtetit: Asnjëra nga shkollat e vizituara nuk mban regjistër të shënimeve për dhunën e raportuar. Në mënyrë që të merren masa ndaj kryesve, provat e qarta të incidenteve duhet të regjistrohen dhe t'i dërgohen DKA-ve.

- Krijimi i shërbimeve këshillimore: Shkollat duhet të pajisen me këshilltar profesional/psikologë të trajnuar në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në shkolla.

- Trajnimi i përfaqësuesve të këshillave të prindërve për të drejtat e fëmijës dhe përgjegjësitë, detyrat e institucioneve relevante dhe, aty ku munden, të adresojnë probleme të ndryshme që shfaqen lidhur me dhunën në shkolla.

- Fuqizimi dhe aktivizimi i këshillave të prindërve në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin rolin e tyre të përshkruar me ligj.

- Vendosja e mënyrës së komunikimit me prindërit përtej takimeve vjetore prindër-mësimdhënës.

- Ofrimi i trajnimeve për mësimdhënësit në lidhje me zgjidhjen e konflikteve.

- Futja e sistemit me dy mësimdhënës (1 plus ndihmës mësim-

dhënësi) për klasë në klasat e ulëta veçanërisht te ato që janë të mbi-populluara. Të pasurit e dy mësimdhënësve do të siguronte mbajtjen e disiplinës, ofrimin e vëmendjes më të madhe për fëmijët sikurse edhe trajnim për mësimdhënës për mësimdhënësit e ardhshëm.

— Një kopje e rregullave të shkollës duhet të hartohet dhe t'i jepet çdo nxënësi dhe prindi. Ato duhet të përfshijnë kodin e sjelljes me theks të veçantë në atë se çka përbën dhuna ndaj mësimdhënësve dhe nxënësve. Gjithashtu duhet të listohen pasojat për sjellje të keqe.

— Ofrimi i përkrahjes shtesë përmes sistemit të mbikëqyrjes për fëmijët që nuk tregojnë rezultate të mira.

— Shkollat duhet të punojnë me Policinë e Komunitetit dhe të rrisin praninë e tyre në shkolla. Të organizojnë ligjërata dhe seanca të pyetje-përgjigjeve me Policinë e Komunitetit për t'i mësuar fëmijët në lidhje me të drejtat e tyre dhe obligimet si dhe institucionet dhe personat relevant ku mund të paraqiten në rast të çfarëdo shkeljeje të drejtës së tyre.

— Instalimi i kamerave vëzhguese të sigurisë në shkolla. Ato ulin rastet e dhunës nxënës-nxënës dhe nëse kryesit e dhunës dhe hajnat e dinë se do të kapen në kamera, atëherë ata do të përmbahen nga veprimi.

— Zbatimi i ligjit që kërkon që nxënësit të veshin uniforma shkollore.

— Secili nxënësi duhet të obligohet që të mbaj një dokument identifikues.

SHTOJCA I. LEGJISLACIONI RELEVANT

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 47: E Drejta për Arsimin	2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.
Neni 50: Të Drejtat e Fëmijës	1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. 3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi. 4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032
(29 Gusht 2011)

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 4: Mbrojtja e grupeve të cënueshme	1. Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese. 2. Ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private. 3. Ndalohen aktivitetet promovuese jashtë Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës në përfitim ose në dëm të çfarëdo partie politike, gjinie, përkatësie racore a etnike, feje ose pozite sociale nëpër institucionet arsimore dhe aftësuese. Kur çështjet relevante paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t'u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta.
Neni 8: Inspektimi i arsimit	6. Pas raportit të inspektorit, i cili nënshkruhet nga inspektori dhe drejtori i institucionit përkatës: 6.1. Ministria mund të ndërpresë punën e institucioneve arsimore dhe aftësuese të cilat nuk janë të licencuara apo veprojnë në ambiente të pasigurta dhe të pashëndetshme. 6.2. Ministria mund të udhëzojë komunën që të ndërpresë marrëdhënien e punës së një mësimdhenësi që është punësuar në kundërshtim me kriteret e specifikuar në këtë ligj, ose është përjashtuar nga puna për shkak të kushteve mjekësore ose urdhrit të gjykatës apo dispozitat e këtij ose ligjeve të tjera në fuqi kërkojnë një gjë të tillë; 6.3. në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit, Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ

Neni 16: Këshilli i Prindërve të Kosovës	2. Funkzioni i KPK-së është përfaqësimi i interesave të prindërve, inkurajim dhe avancim i rolit të prindërve si palë e rëndësishme e interesit në promovimin e cilësisë në arsim, përcjellja e mendimeve të prindërve te Ministria lidhur me çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar dhe të jetë kanali kryesor i komunikimit dhe këshillimit mes Ministrisë, institucioneve arsimore e aftësuese dhe prindërve. 3. Ministria nxjerr akt nënligjor për punën e KPK-së, procedurat për emërimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të tij, duke përfshirë gjithmonë anëtarë të komuniteteve jo shumicë. 4. Ministria siguron buxhetin vjetor dhe infrastrukturën logjistike që të mundësojë punën efektive të KPK-së.
Neni 18: Këshilli i nxënësve	1. Këshilli drejtues i çdo shkolle të nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it themelon një këshill të nxënësve, i cili duhet të ketë së paku një nxënës të zgjedhur nga secila klasë dhe që zgjidhet çdo vit përmes votës së fshehtë. 2. Roli i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohen në këshillin drejtues.
Neni 19: Këshilli i prindërve	4. Prindërit, përveç përfaqësimit në Këshillin e Prindërve, kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre, drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues, komunës dhe Ministrisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin shkollos.
Neni 20: Personeli udhëheqës	2. Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë: 2.1. caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve; 2.2. detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit;
Neni 22: Rregullat e shkollës	1. Komuna, pas pranimit të propozimit të këshillit drejtues të shkollës, miraton rregullat e parapara për të promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, dhe për të promovuar konceptin e shkollave të shëndetshme dhe eliminimin e dhunës. 2. Rregullat e shkollës i caktojnë të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që nuk janë parashikuar në këtë ligj apo aktet nënligjore të nxjerra sipas tij, por ato janë të bazuara gjithmonë në legjislacionin në fuqi. 6. Obligohen nxënësit për bartjen e uniformes shkollore

Ligji Nr. 03/L-068 Për Arsimin Në Komunate Republikës Së Kosovës

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 5: Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë)	h) mbikëqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i; i) përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore; U) monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu si përcaktohet nga legjislacioni;

Ligji Nr. 2004/37 Për Inspeksionin E Arsimit Në Kosovë

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 4: Detyrat e Inspeksionit të Arsimit	4.3. Inspektorët e arsimit posaçërisht kanë për detyrë të inspektojnë: s. Realizimin e të drejtave dhe të detyrave të nxënësve, të studentëve dhe të punësuarve të tjerë në harmoni me ligjin; t. Masat disiplinore të shqiptuara ndaj nxënësve, studentëve, mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të institucionit;
Neni 5: Kompetencat dhe autorizimet e inspektorit të arsimit	5.4. Inspektorët e arsimit ndërpresin dhe ndalojnë: d. Marrëdhënien e punës të të punësuarit, i cili e ka të ndaluar nga komisioni mjekësor ose nga gjyqi të punojë me fëmijë, nxënës dhe studentë. Në këtë kategori hyjnë edhe personat që kanë mbushur moshën 65 vjeçare. Kriteri i moshës zbatohet në fillim të vitit shkollor-akademik; e. Marrëdhënien e punës së mësimdhënësit, i cili nuk e realizon planin dhe programin mësimor në pikëpamje kuantitative dhe kualitative; f. Nëse inspektori arsimor konstaton se personi i autorizuar i institucionit arsimor, ose punëtori tjetër ka bërë kundërvajtje: delikt fizik, moral, ekonomik, korrupsion, fyerje në baza nacionale, fetare ose vepër tjetër penale, do t'ia paraqesë kërkesën organit kompetent për fillimin e procedurës.

Neni 7: Sanksionet administrative

7.1. Institucioni arsimor dënohet për kundërvajtje me të holla në shumë prej 500-1.000 Euro, kurse personi i autorizuar në shumë prej 50-100 euro nëse:

- a. inspektorit të arsimit nuk i krijohen kushte për inspektim;
- b. nuk i ofron dokumentacionin e kërkuar (neni 4.8); dhe
- c. nuk vepron sipas vendimit të inspektorit (neni 5.1; 5.2).

7.2. Institucioni arsimor dënohet prej 1.000-2.000 €, kurse përgjegjësi i autorizuar prej: 100-200 €, nëse:

- a. Nuk krijon kushte normale për mësim në institucionin arsimor;
- b. Refuzon zbatimin e masave të urdhëruara me vendim të inspektorit.

Udhëzim Administrativ 28/2012 për Themelimin dhe Funksonimin e Këshillit të Prindërve të Kosovës (KPK) (31 Dhjetor 2012)

<i>Nenet</i>	<i>Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse</i>
Neni 2: Themelimi	1. MASHT themelon Këshillin e Prindërve të Kosovës (KPK). 2. DKA themelon Këshillin e Prindërve të Komunës (KPK). 3. Shkolla themelon Këshillin e Prindërve të Shkollës (KPSH).
Neni 3: Roli dhe përgjegjësitë	1. Këshilli i Prindërve të Kosovës, përfaqëson interesat e prindërve dhe i përcjell mendimet e tyre në MASHT për të gjitha çështjet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Gjithashtu, është mekanizëm kryesor i komunikimit dhe i këshillimit ndërmjet MASHT-it dhe prindërve. 2. Këshilli i Prindërve të Komunës: 2.1. Përfaqëson interesat e nxënësve dhe të prindërve në institucionet e arsimit parauniversitar; 2.2. Organizon prindërit për të mbështetur shkollën dhe arsimtarët në veprimtarinë edukativo-arsimore; 2.3. Krijon mekanizmat e komunikimit midis MASHT-it dhe prindërve. 3. Këshilli i Prindërve të Shkollës: 3.1. Përfaqëson interesat e nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve; 3.2. Bashkëpunon në të mirë të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie; 3.3. Ndihmon në krijimin e shkollave mike për fëmijë dhe më atraktive për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Udhëzim Administrativ: 491/01B Kodi i Etikës për vlerësimin e nxënësve (23 Dhjetor 2011)

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 2: Funksioni i Kodit të Etikës për Vlerësim	3. Kodi Etik për vlerësimin e nxënësve ndihmon që vlerësimi të kryhet në përputhje me parimet themelore etike të shoqërisë civile: korrektësi, drejtësi, respekt për të gjithë individët dhe parimet demokratike.
Neni 3: Rëndësia e Kodit të Etikës për Vlerësim	2. Vlerësimi me bazë në shkollë i arritjes së të nxënërit të nxënësve, është i rëndësishëm për nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe për drejtorët e shkollave. Kur vlerësimi përdoret për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien (Vlerësimi për Nxënie) ose të raportojë të nxënërit e arritur (Vlerësimi i të Nxënërit), atëherë ai duhet të kryhet saktë dhe drejtë, duke respektuar rregullat, udhëzimet dhe dokumentet zyrtare, po ashtu duhet respektuar parimet demokratike, dhe të drejtat e barabarta të të gjithë individëve, pa marrë parasysh etninë, fenë, gjininë, gjendjen sociale apo ndonjë faktor tjetër.
Neni 4: Përkufizimi, parimet dhe zbatimi i Kodit të Etikës për Vlerësim	11. Kodi i Etikës për vlerësimin e nxënësve përcakton gjashtë parime themelore që duhet të respektohen në të gjitha aspektet e jetës së shkollës: 1.1. Respektimi i ligjit dhe i parimeve demokratike. 1.2. Respekti për individët, të drejtat e tyre dhe dallimet individuale. 1.3. Drejtësi dhe korrektësi të barabartë për të gjithë në zbatimin e rregullave dhe procedurave të vlerësimit të nxënësve. 1.4. Standardet më të larta të integritetit në të gjitha aspektet e procesit të vlerësimit. 1.5. Saktësi në mbledhjen e informatave për të arriturat e nxënësve dhe raportimit të tyre. 1.6. Promovimi i standardeve më të larta të sjelljes dhe të arritjes së të nxënërit gjatë gjithë kohës.
Neni 5: Përdoruesit e Kodit të Etikës për Vlerësim	2. Mësimdhënësit pranojnë të: 2.1. Ndjekin kodin e etikës së shkollës për vlerësimin e nxënësve në veprimtarinë e tyre personale të vlerësimit. 2.4. Respektojnë të drejtat e të gjithë nxënësve, dhe kërkojnë t'i trajtojnë të gjithë nxënësit njësoj, pavarësisht nga gjinia, etniciteti, feja, faktorët social dhe faktorët tjerë.

Udhëzim Administrativ 40/2005: Ndalimi, ndërprerja e punës dhe iniciimi i procedurës disiplinore ndaj mësimeve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore. (28 Shtator 2005)

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 2: Ndalimi, ndërprerja dhe iniciimi i procedurës disiplinore	Inspektori i arsimit, ndalon, ndërpre punën e mësimeve dhe punëtorëve në institucionet edukativo- arsimore, shkencore dhe aftësuese si dhe e fillon procedurën e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj tyre, nëse konstaton se: c) mësimeve ose i punësuari tjetër është i dënues për ndonjë vepër penale, për të cilin parashihet dënimi në kohëzgjatje me më shumë se 6 (gjashtë) muaj burg efektiv; d) nuk e zbaton ligjin dhe aktet e tjera nënligjore; e) përdor dhunën fizike ndaj fëmijëve, nxënësve, studentëve dhe kolegëve; f) bën ndonjë akt ngacmimi apo dhunimi seksual; gj) merr mito nga fëmijët, nxënësit , studentët dhe prindërit për përmirësim notash, kalim klase, dhënie provimi e të tjera të ngjashme; o) Bën diskriminim ndaj fëmijëve, nxënësve dhe studentëve për shkak të racës, gjinisë, ngjyrës, besimit, të hendikepuarve, origjinës vendore, statusit; p) nxit urrejtje dhe dhunë kundër të tjerëve;
Neni 3: Njoftimi i inspektorit arsimor	3.1. Inspektori i arsimit pas konstatimit të lëshimeve, e informon personelin edukativo-arsimor shkencor dhe aftësues, mbikëqyrësin dhe punëdhënësin me shkrim për lëshimet e konstatuara dhe më pas duhet të nxjerrë vendim për ndalim, ndërprerje të punës dhe inicon procedurën për masën disiplinore. 3.2. Inspektori arsimor menjëherë duhet t'i raportojë kryeinspektorit për masën e marrë, njëherit e informon edhe DKA-në dhe ZRA-në.

Udhëzim Administrativ Nr. 11/2005 për Procedurat Administrative të Inspektimit në Institucionet Edukative- Arsimore dhe Shkencore (04 April 2005)

Neni 2: Parimet kryesore

Shërbimi i inspektimit të arsimit udhëhiqet nga parimet e përgjithshme të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Ligjit të Arsimit të Lartë, Ligjit për Inspektionin e Arsimit në Kosovë, Rregullores së UNMIK nr. 36/ 2001 dhe akteve tjera nënligjore, si:

2.1 2.1. Të gjitha rastet të trajtohen në mënyrë objektive, pa anim, pa diskriminim mbi baza etnike, fetare, gjinore, sociale, racore dhe të moshës;

2.2. Inspektimi nuk zbatohet për të dënuar institucionin arsimor apo individin;

2.3. Inspekcioni nxjerr akte administrative dhe juridike për t'iu ndihmuar institucioneve arsimore dhe personave fizik në respektimin e ligjit dhe të rendit në sistemin e arsimit;

Neni 9: Konkludimet dhe rekomandimet

9.1. Në bazë të përpunimit të të dhënave konstatohet gjendja faktike dhe nxirren konkludimet për shkallën e zbatimit të ligjshmërisë apo për shkallën dhe natyrën e shkeljes së ligjshmërisë nga ana e institucionit përkatës arsimor.

9.2. Varësisht nga gjendja faktike nga 9.1. udhëheqësi i ekipit apo kryeinspektori bën përpilimin e rekomandimeve se çka, kush dhe si duhet të përmirësohet zbatimi i ligjshmërisë në institucionin arsimor përkatës.

9.3. Rekomandimet i nënshkruan kryeinspektori dhe pastaj i dërgohen institucionit përkatës arsimor dhe nga një kopje autoriteteve përgjegjëse në MASHT.

Neni 10: Nxjerrja e vendimeve

10.1. Udhëheqësi i ekipit, në përputhje me afatet e përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga rekomandimet e nxjerra, bën mbikëqyrjen e shkallës së përmbushjes së tyre nga ana e institucionit arsimor përkatës.

10.2. Institucioni arsimor përkatës ka të drejt të kërkojë interpretim dhe udhëzime shtesë nga shërbimi i inspektionit për zbatimin e rekomandimeve.

10.3. Nëse institucioni arsimor përkatës nuk bënë zbatimin e rekomandimeve në afatin e paraparë edhe pas vërejtjes me shkrim, atëherë kryeinspektori nxjerr vendim me të cilin shqiptohen masat ligjore ndaj institucionit arsimor përkatës.

10.4. Nëse institucioni arsimor përkatës është i pakënaqur me vendimin e kryeinspektorit ka të drejtë t'i paraqes ankesë Sekretarit të Përhershëm.

10.5. Sekretari i Përhershëm në bazë të ankeses e ngrit një komision të veçantë dhe verifikon procedurat e nxjerrjes së vendimit dhe merr vendim përfundimtar në procedurën administrative për çështjen e caktuar.

Udhëzim Administrativ Nr. 13/2005 për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar.

(23 Mars 2005)

Nenet	Dispozitat/detyrimet/sanksionet përkatëse
Neni 3: Masat ndëshkuese	3.1. Në qoftë se një nxënës nuk është i regjistruar apo mungon në procesin e arsimit të detyruar, prindi i tij (saj) detyrohet të paguaj gjobë, po që se mungesa apo mosvijimi vjen si rezultat i veprimeve të qëllimshme apo nga neglizhenca e prindit .
Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016	
<i>Zhvillimi dhe ndërmarrja e masave këshillimore për të reduktuar sjelljet agresive dhe problemet disiplinore.</i>	Huliganizmit shpesh i nënshtrohen nxënësit nga familjet e varfëra, nga komunitetet minoritare dhe nga grupet e marginalizuara, ose nga fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Nxënëset, gjithashtu i nënshtrohen diskriminimit gjinor. Huliganizmi dhe ngacmimi në shkollë janë zakonisht manifestime verbale, mirëpo ka raste kur shprehet edhe në dhunë fizike. Shkollat ndikohen edhe nga ngjarjet në bashkësinë më të gjerë, siç janë për shembull dukuritë më të shpeshta të kulturës
<i>Caqet: Janë dymbëdhjetë objektiva të qarta strategjike sektoriale që parashtrojnë dymbëdhjetë fusha problemore që duhen trajtuar gjatë periudhës 2007-2017:</i>	APU 10. . Deri në vitin 2016 shkollat kanë krijuar mjedise jo të dhunshme dhe miqësore për fëmijët në shkolla që janë përkrahëse, të kujdesshme dhe i kultivojnë vlerat demokratike të fëmijët dhe ofron modele pozitive për të gjithë fëmijët

SHTOJCA II. RASTET E RAPORTUARA TË DHUNËS QË JANË IDENTIFIKUAR NË INTERVISTA

Gjinia dhe Klasa e të intervistuarit	Rasti	Shkolla	Kryesi	Lloji i dhunës	Viktima
Femër (Klasa e 6-të)	1.0	Emin Duraku	Mësimdhënësi	Tërheqja e veshit dhe shuplakë	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 6-të)	2.0	Ismail Qemajli	Mësimdhënësi	Shuplakë	I intervistuari
Femër (Klasa e 6-të)	3.0	Naim Frasheri	Mësimdhënësit	Shuplakë	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 6-të)	4.0	Thimi Mitko, Gjilan	Mësimdhënësi	Bërtimë, shuplakë	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 6-të)	5.0	Dardania	Mësimdhënësit	Tërheqja e veshit, shuplakë, bërtimë	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 7-të)	6.0	Elena Gjika	Mësimdhënësi	Shuplakë	I intervistuari
Femër (Klasa e 7-të)	7.0	Elena Gjika	Mësimdhënësi	Dhunë seksuale, përdorimi i fjalëve të ndyta në bisedë me vajzat. Prekja	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 7-të)	8.0	Iliria	Mësimdhënësit	Shuplakë, rrahje	I intervistuari
Femër (Klasa e 7-të)	9.0	Naim Frasheri	Mësimdhënësi	Shuplakë	I intervistuari
Femër (Klasa e 7-të)	10.0	Thimi Mitko, Gjilan	Mësimdhënësi	Tërheqja e veshit, gjuhë ofenduese [ndaj djemve kryesisht]	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 7-të)	11.0	Dardania	Mësimdhënësit	Shuplakë	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 7-të)	12.0	Elena Gjika	Mësimdhënësi	Shuplakë (është kërcënuar se do t'i rrah më shumë nëse nuk binden)	E tërë klasa është shpultosur
Femër (Klasa e 7-të)	12.1	Elena Gjika	Mësimdhënësi	Rrahje	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 7-të)	12.2	Elena Gjika	Mësimdhënësi	Dhunë seksuale, prekje e papërshtatshme	I intervistuari
Mashkull (Klasa e 7-të)	13.0	Thimi Mitko, Gjilan	Mësimdhënësi	Tërheqja e veshit	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 8-të)	14.0	Iliria	Students	Drejtimi kah fëmijët me gjuhë ofenduese	Mësimdhënësit
Mashkull (Klasa e 8-të)	15.0	Emin Duraku	Mësimdhënësit	Shuplakë, bërtimë shumë shpesh	I intervistuari dhe shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 8-të)	16.0	Iliria	Mësimdhënësit	Bërtimë, shuplakë	Shokët e klasës
Mashkull (Klasa e 8-të)	17.0	Naim Frasheri	Mësimdhënësit	Tërheqja e veshit	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 8-të)	18.0	Naim Frasheri	Mësimdhënësit	Tërheqja e veshit	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 8-të)	19.0	Pjeter Bogdani	Kujdestari	Rrahje, shuplakë, bërtimë	Shoku i klasës
Femër (Klasa e 8-të)	20.0	Gjergj Fishta	Mësimdhënësi	Shuplakë	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 9-të)	21.1	Musa Zajmi, Gjilan	Kujdestari	Rrahje deri në alivanosjen e fëmijës	Shoku i klasës
Mashkull (Klasa e 9-të)	21.2	Musa Zajmi, Gjilan	Mësimdhënësi	Drejtimi kah fëmijët me gjuhë ofenduese	Shokët e klasës
Mashkull (Klasa e 9-të)	22.0	Musa Zajmi, Gjilan	Mësimdhënësi	Shuplakë	I intervistuari

SHTOJCA III. PYETËSORI NË GJUHËN SHQIPE

Organizata Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është duke bërë një studim mbi mirëqenien dhe sigurinë e fëmijëve nëpër shkolla. Studimi përfshinë një numër të madh të shkollave në Komunën e Prishtinës. Të anketuarit për këtë studim përfshijnë: nxënës të moshës 11–15 vjeç (klasat 5–9), arsimtarë, profesorë, zyrtarë publik. Te gjitha te dhënat e mbledhura për këtë studim janë konfidenciale. Ky hulumtim do i vihet në shërbim Komisionit Parlamentar për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të zhdukur dhe peticione.

JU FALENDEROJMË PARAPRAKISHT

Gjinia: M F
 Mosha (sa vjeç jeni?) _____
 Në cilën klasë jeni? _____

1.1. Gjatë javës që shkoi, sa herë kanë shpërndarë thashetheme për ju?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.2. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë përqeshur, ju kanë vënë emra nënçmues apo ju kanë ofenduar në shkollë?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.3. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë kërcënuar?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.4. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë shtyrë të bëni gjëra jashtë vullnetit tuaj?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.5. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë dëmtuar gjërat?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.6. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë penguar të merrni pjesë në ndonjë aktivitet (p.sh. të merrni pjesë në ndonjë lojë)?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.7. Gjatë javës që shkoi, sa herë ju kanë shtyrë, qitë «kleçkën» apo ju kanë pështyrë?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.8. Gjatë javës që shkoi, sa herë kanë postuar në facebook apo ju kanë dërguar sms ofendues?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.9. A keni vërejt nëse ndonjë shok apo shoqe e juaja është shpesh objekt ngacmimi?

- Asnjëherë
 - Njëherë
 - Më shumë se njëherë
 - Vazhdimisht
-

1.10. Nëse keni vërejt që shoku/shoqja juaj është objekt ngacmimi, tregoni në çfarë mënyre ngacmohet nga të tjerët.

1.11. Kujt i drejtoheni kur ju ngacmojnë në shkollë? [Shënoni numrin afër personit duke u bazuar sa shpesh i drejtoheni kur ju ngacmojnë. 1= më së shpeshti, 2= shpesh, 3= ndonjëherë, 4= rrallëherë, 5= asnjëherë]

- ___ Shokut/shoqes së ngushtë
 - ___ Prindërve
 - ___ Drejtorit të shkollës
 - ___ Arsimtarëve
 - ___ Policisë
 - Dikujt tjetër: _____
-

1.12. Kujt i drejtoheni për çfarëdo problemi në shkollë? [Shënoni numrin afër personit duke u bazuar sa shpesh i drejtoheni kur ju ngacmojnë. 1= më së shpeshti, 2= shpesh, 3= ndonjëherë, 4= rrallëherë, 5= asnjëherë]

- ___ Shokut/shoqes së ngushtë
- ___ Prindërve
- ___ Drejtorit të shkollës
- ___ Arsimtarëve
- ___ Policisë
- Dikujt tjetër: _____

2.1. A dënohesh në shkollë?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.2. Cilat janë format më të shpeshta të ndëshkimit?

- ____ Tërheqja e veshit
 - ____ Tërheqja e zylyfeve
 - ____ Tërheqja e flokëve
 - ____ Shuplaka
 - ____ Goditja në kokë (p.sh. me kimik)
 - ____ Tjetër: _____
-

2.3. A dënoheni në shkollë për shkak të mos mësimi?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.4. A dënoheni në shkollë për shkak të vonesës?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.5. A i rrahin arsimtarët nxënësit kur bëjnë zhurmë?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.6. A ju rrahin arsimtarët kur janë nervoz?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.7. A ju drejtohen arsimtarët me fjalë fyese ose nënçmuese?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
-

2.8. Kur arsimtarët ju drejtohen me fjalë fyese, cilat fjalë i përdorin më së shpeshti?

2.9. A ju ka ngacmuar seksualisht ndonjë arsimtar?

- Asnjëherë
 - Ndonjëherë
 - Shpesh
 - Vazhdimisht
 - Tjetër: _____
-

Nëse përgjigja është po, na tregoni si ka ndodh: _____

